



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5273 prot.

Shkodër, me 06 . 2020

Lënda: Dërgohet vendimi nr. 16, datë 3.4.2020 i këshillit bashkiak Shkodër

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Shkodër

Bashkëlidhur ju dërgojmë :

Vendimin nr.16, datë 3.4.2020 të këshillit bashkiak

**PËR MIRATIM REZOLUTE**

*Duke ju falenderuar,*

**Denis LESH**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr.16 , date 3.4.2020**

**PËR MIRATIM REZOLUTE**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 3.4.2020, me propozim të kryesisë së këshillit bashkiak, bazuar në nenin 54, shkronja “k”, 55, pika 2, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e keshillit bashkiak”, me 36 vota Pro,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Rezolutës, sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Kjo Rezolutë i dërgohet Kryetares së Bashkisë dhe për dijeni Prefektit të Qarkut Shkodër.

**Sekretar i Keshillit**

**Denis Lesha**

**KRYETAR**

**Brigjeta KADUJA**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**REZOLUTË**

**MBI MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA PËR SHKAK TË SITUATËS SË  
KRIJUAR SI REZULTAT I PANDEMISË TË SHKAKTUAR NGA COVID-19**

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Shkodër”, duke marrë në konsideratë rolin e Këshillit Bashkiak, si organi përfaqësues i Njësisë së Qeverisjes Vendore (Bashkia Shkodër), si përfaqësues i vullnetit të qytetarëve të Shkodrës;

- Duke ndjekur me shqetësim situatën e krijuar në vendin tone për shkak të COVID-19;
- Duke qenë të vetëdijshëm, që masat e detyrueshme shtrënguese të marra për parandalimin e përhapjes së COVID-19, kanë krijuar impakt të drejtëpërdrejtë në cilësinë e jetës dhe aspekte të rëndësishme ekonomike-sociale të qytetarëve/bizneseve/grupeve vulnerabël në qytetin e Shkodrës;
- Duke marrë në konsideratë masat parandaluese dhe ato që vijnë në ndihmë të bizneseve/individëve apo shtresave të caktuara shoqërore, të ndërmarra nga qeveria shqiptare, ndër të cilat por jo vetëm:
  1. VKM nr.243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”
  2. Aktin normativ nr.11, datë 27.3.2020 “Për një shtesë në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar;
  3. VKM nr.254, datë 27.3.2020 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri në 14 milion lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e COVID-19”,
  4. Aktit normativ nr.10, datë 26.3.2020 “Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;

5. Aktit normativ nr.3, datë 15.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohës së kohëzgjatjes të periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19;
  6. Vendimin e Komitetit Ndërmënytorë të Emergjencave Civile nr.1, datë 25.3.2020 “ Për konfirmimin dhe vijimin e zbatimit të masave të veçanta administrative të marra gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-2020”
- Duke vlerësuar përpjekjet e deritanishme të Bashkisë Shkodër, në menaxhimin e situatës, të krijuar për shkak të kësaj pandemie.
  - Duke vlerësuar të domosdoshme, marrjen e masave të menjëhershme për përbalimin e pasojave ekonomike/sociale, të shkaktuara nga epidemia COVID-19;
  - Duke vlerësuar se COVID-19, ka pasur dhe vijon të ketë një impakt thelbësorë në ekonominë lokale, duke limituar apo mbyllur në mënyrë të përkohëshme shërbimet e ofruara nga biznese të ndryshme, duke krijuar vështirësi financiare, të banorëve të Bashkisë Shkodër;
  - Duke synuar parandalimin e mëtejshëm të përhapjes së epidemisë, nëpërmjet masave të kërkuara për tu aplikuar nga qeveria, institucionet publike të qeverisë, apo ekspertët e fushës, si distancimi social, qëndrimi në shtëpi, shmangja e lëvizjeve të panevojshme, dezinfektimi i ambjentëve publike, tregjeve, institucioneve, etj;
  - Duke synuar sigurimin e një jetese sa më normale në kushtet e fatkeqësisë natyrore, si dhe plotësimin e nevojave bazike, ndihmës financiare, mjeteve bazë të jetesës, të komunitetit të qytetit tonë;
  - Duke synuar në reduktimin e impaktit ekonomik negativ dhe mbrojtjen e mirëqenies së banorëve të Bashkisë Shkodër, për shkak të COVID-19;

### **Këshilli Bashkiak Shkodër, i kërkon Kryetares së Bashkisë Shkodër:**

1. Forcimin e mëtejshëm të masave për parandalimin e përhapjes së epidemisë COVID-19;
2. Rishikim të paketës fiskale, duke synuar lehtësira fiskale për një periudhë 3 deri në 6 muaj, për ato biznese të cilët janë mbyllur për shkak të masave kufizuese, individë të papunë, të mbetur pa punë, apo shtresat në nevojë;
3. Të rishikohet buxheti i bashkisë Shkodër i miratuar për vitin 2020, duke i rishpërndarë fondet, në zërat dhe programet me emergjente që i përgjigjen situatës së krijuar për shkak të COVID-19;
4. Anullim dhe rishpërndarje të fondeve, të parashikuara për aktivitete artistike, kulturore dhe sportive gjatë gjithë periudhës kufizuese të zhvillimit të këtyre aktiviteteve dhe kalimin e këtyre fondeve në favor të komunitetit, duke synuar zvogëlimin e pasojave të rrjedhura nga situata e krijuar;
5. Anullimin e ndërtimit të fushave sportive të programuara për vitin 2020;
6. Rivlerësim të investimeve në infrastrukturë, me synim reduktimin e tyre sipas planifikimit për vitin 2020;
7. Rishikim të buxhetit të K.F.Vllaznia sh.a., duke shkurtuar ato fonde të planifikuara për aktivitete sportive gjatë periudhës kufizuese;

8. Vlerësim dhe planifikim të fondeve shtesë për përballimin e shpenzimeve dhe shpërndarjeve të paketave ushqimore për shtresat në nevojë, apo pensionistëve që jetojnë vetëm, gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit për shkak të COVID-19, në territorin e Bashkisë Shkodër;
9. Vlerësim dhe planifikim të fondeve shtesë për dezinfektimin e ambjenteve publike, godinave administrative të Bashkisë Shkodër, strukturave të varësisë, si dhe të gjitha objekteve arsimore;
10. Secila qendër komunitare apo rajoni të identifikojë nevojat e të moshuarve që ka në zonë duke u bërë koordinues për shërbimet shëndet-pensione-shërbime komunitare (pazare-blerje ilaçe, etj.)
11. Faljen e kamatë-vonesave, të faturave të ujit për kategoritë e përmendura në pikën 8 të kësaj rezolute, si dhe spitalit rajonal Shkodër;
12. Përsa është e mundur të krijohet një fond i posaçëm për COVID-19, ku përfshihen donacione të ndryshme, shërbime, grante, pajisje, mjete apo vlera të tjera të siguruar nga subjekte private, OJF apo burime qeveritare, të destinuar për të ardhur në ndihmë personave/shtresave vulnerable, të prekur nga impakti negativ i epidemisë;
13. Të rishikojë kontratat për punë dhe shërbime publike në përputhje me nevojat që adreson situata e krijuar për shkak të epidemisë COVID-2019.
14. Raportim javor në Këshillin Bashkiak, mbi masat e marra (të përditësuara), në përballimin e kësaj situatë.
15. Përfshirjen e anëtarëve të këshillit bashkiak në grupet operationale në terren, apo grupe pune/komisione të emergjencës, të ngritur nga Bashkia Shkodër, për koordinimin dhe menaxhimin e situatës së krijuar për shkak të COVID-19

**Sekretar i Keshillit**

  
**Denis Lesha**

**KRYETAR**

  
**Eriçela KADLJA**